

Informacione bazë mbi programin e landit për familjet



Çfarë është STÄRKE dhe kush mund të marrë pjesë në të?

STÄRKE është një program i landit që synon të mbështesë prindërit në aftësitë e tyre prindërore dhe të përmirësojë mundësitë e zhvillimit të fëmijëve të tyre. Për këtë qëllim, në qytetet, qarqet e qytetit dhe të landit Baden Vyrtemberg ka ofrues dhe shërbime lokale që ofrojnë mundësi arsimimi familjar për prindërit (e ardhshëm).

Cilat janë ofertat e STÄRKE?

Takime të hapura

Takimet e hapura janë në dispozicion, falas, të të gjitha familjeve për t'u takuar dhe shkëmbyer ide. Ato janë vende arsimore lehtësisht të arritshme për familjet (e ardhshme) në të gjitha fazat e familjes. Aty mund të diskutohen tema lidhur me nevojat aktuale të prindërve dhe mund të merren informacione mbi oferta të tjera dhe mundësi mbështetjeje financiare për familjet.

Oferta për familjet në situata të veçanta jete

Nëse gjendeni në një situatë të veçantë jete, ju mund të përfitoni nga ofertat e përshtatura për situatën tuaj me zbritje ose pa pagesë. Pjesëmarrja nuk varet nga mosha e fëmijës suaj.

Në një situatë të veçantë jete, kjo mund të jetë, ndër të tjera

- familje me një prind,
- prindër veçanërisht të rinj (të paktën një prind nën moshën 18 vjeç),
- familje me disa fëmijë,
- familjet që jetojnë të ndara,
- familje me prindër të së njëjtës gjini,
- familje me eksperiencë refugjate dhe familje emigrante,
- familje me eksperiencë dhune,
- familje ku një anëtar i saj është i sëmurë (përfshirë varësinë), që ka nevojë për kujdes infermieror ose me aftësi të kufizuara.

Kampet e edukimit familjar

Familjet në situata të veçanta jete mund të marrin pjesë gjithashtu në një kamp edukimi familjar ose fundjavë të përshtatur për grupin e tyre të synuar. Këtu është e mundur gjithashtu një mbështetje bështetja financiare.

Ku mund të gjej informacione mbi ofertat e STÄRKE?

Informacione mbi ofertat mund të merrni nga autoritetet përgjegjëse për familjet në bashki ose zyrën e këshillit të Landit apo në faqen kryesore të qytetit ose qarkut tuaj. Qendrat prindër-fëmijë, qendrat e nënës ose ofrues të tjerë të edukimit familjar mund t'ju ofrojnë gjithashtu informacione mbi ofertat aktuale.